



Komisioni
Evropian

Bruksel, 10.10.2012
COM(2012) 602

KOMUNIKATË NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN DHE KËSHILLIN

mbi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës

{SWD(2012) 339}

□ Ky dokument nuk e prejudikon qëndrimin mbi statusin dhe është në pajtim me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe Mendimin e GJND-së mbi deklaratën e Kosovës për pavarësi

KOMUNIKATË NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN DHE KËSHILLIN

mbi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës

1. Hyrje

Parimet kryesore të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) janë vënë në Komunikatën e Komisionit të bërë në Maj 1999¹ dhe janë konfirmuar në Qershor të vitit 1999. Përmes këtij procesi, Bashkimi Evropian (BE) shpreh vendosmërinë që të përballet me sfidat dhe të merr përgjegjësinë për të kontribuar në stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Si rezultat i përmbyshjes së kushteve përkatëse, BE-ja u ofron shteteve marrëdhënie të caktuara kontraktuale: Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Kushtet për vënien e marrëdhënieve kontraktuale me vendet e Ballkanit Perëndimor janë caktuar në Përfundimet (Konkluzionet) e Prillit të vitit 1997. Elementet kryesore përfshijnë një angazhim të mirëfilltë në përmbyshjen e reformave demokratike, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pakicave dhe lirinë e shprehjes dhe zgjedhjet e lira dhe të rregullta. Këshilli po ashtu pret zbatimin e reformave të para ekonomike, ri-pranimin nga shtetet anëtare dhe përkushtimi ndaj bashkëpunimit rajonal.

Këshilli Evropian në takimin e mbajtur në Feira (Qershor 2000) ka dhënë shenja të qarta për rajonin e Ballkanit Perëndimor që dëshirojnë statusin e kandidatit potencial për anëtarësim. Ky mesazh është përforcuar në samitin e Zagrebit (Nëntor 2000). Përfundimet e Këshillit Evropian nga Marsi i vitit 2003 pohojnë që e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është brenda BE-së dhe se kërkohet një vullnet i fortë politik dhe përpjekje të qëndrueshme për të siguruar këtë të ardhme. Agjenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor e Qershorit të vitit 2003 e bën të qartë që vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe përkrahja e tyre për integrim në strukturat Evropiane dhe anëtarësimi i tyre përfundimtar në Bashkim, është prioritet i lartë për BE-në.

Deri më tani janë përgatitur studimet për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë dhe Malin e Zi. Pas kësaj janë nënshkruar Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit me të gjitha këto vende. Në Dhjetor të vitit 2011 Këshilli e ripërsërit vullnetin e BE-së për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës përmes një agjende të qartë evropiane, në përputhje me perspektivën evropiane të rajonit. Këshilli nënvizon nevojën e ndërmarrjes së hapave konkret në këtë drejtim. Në Shkurt të vitit 2012, Këshilli vihet në dijeni për qëllimin e Komisionit që të nisë studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, pa prejudikuar qëndrimin e Shteteve Anëtare mbi statusin apo çfarëdo vendimi të ardhshëm që do të merret nga Këshilli.

Në kontekst të Rekomandimeve të Këshillit të Shkurtit të vitit 2012, Komisioni ka bërë një Deklaratë në të cilët thuhet se "studimi i fizibilitetit nga ana e Komisionit do të vlerësojë nëse kriteret politike, ekonomike dhe ligjore për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit janë përmbyshur. Nisja e studimit të fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Kosovës nuk prejudikon qëndrimin e Shteteve Anëtare mbi statusin ligjor dhe njohjen e Kosovës".

¹ Ky dokument nuk e prejudikon qëndrimin mbi statusin dhe është në pajtim me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe Mendimin e GJND-së mbi deklaratën e Kosovës për pavarësi.

¹ COM(1999) 235 final.

Metodologjia

Ky studim është i bazuar në gjetjet e paraqitura nga Dokumentin e Punës së Komisionit.² Kjo është përpiluar në bazë të pyetësorit të plotësuar nga autoritetet e Kosovës, një mision vlerësues prej 20 ekspertëve, kontributet nga Zyra e BE-së në Prishtinë, organizatat ndërkombëtare dhe jo-qeveritare. Studimi e vlerëson Kosovën nëse është e gatshme të negocioj dhe pastaj edhe të zbatoj Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Dokumenti i përmend çështjet prioritare dhe fushat prioritare të cilat duhet ti adresoj Kosova para se negociatat të fillojnë ashtu që të jetë në gjendje të përmbush obligimet e parapara në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Aspektet ligjore

Mundësia e Bashkimit për të nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare nuk është e kufizuar vetëm në shtetet e pavarura apo në organizatat ndërkombëtare. Marrëveshjet e tilla mund të nënshkruhen me secilën palë atëherë kur Pala Tjetër pranon të hyjë në marrëdhënie kontraktuale që janë të rregulluara nga e Drejta Ndërkombëtare Publike. Në të kaluarën BE-ja ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare me disa subjekte që nuk kanë qenë shtete sovrane.

Këto marrëveshje janë miratuar nga Këshilli në bazë të Nenit 218 të Traktatit të Funkcionimit të BE-së (TFBE) (apo artikujt pararendës, Neni 300 –dhe para tij 228-KE). Në këtë kontekst, është me rëndësi të vihet re që përdorimi i Nenit 218 TFBE, si një bazë ligjore për një marrëveshje me Kosovën nuk përbën pranim të Kosovës nga ana e BE-së si shtet i pavarur e as nuk përbën njohje nga Shtetet individuale Anëtare, duke qenë se kjo është çështje e rezervuar e shteteve. Ngjashëm, kjo nuk paraqet as tërheqje e njohjes nga ana e Shteteve Anëtare të cilat e kanë dhënë një njohje të tillë.

Nuk ka pengesa ligjore për BE-në që të lidh marrëveshje me Kosovën në këtë kuptim. Nuk ka përkufizim të saktësuar për këtë në të drejtën e BE-së: Neni 217 TFBE përkufizon që një marrëveshje e tillë vendos "një asociacion që përfshin të drejta dhe obligime të ndërsjella, veprime të përbashkëta dhe procedura të veçanta". Kjo rrjedh nga praktika e BE-së që marrëveshjet e asociimit krijojnë lidhje të veçanta dhe të privileguara me një vend të tretë. Në veçanti, marrëveshjet e asociimit i vejnë theks në vlerat dhe parimet e përbashkëta, paraqesin një komponent të rëndësishëm tregtar, ofrojnë përafrimin e legjislacionit kombëtar të vendeve me programet dhe politikat kryesore të BE-së dhe organizojnë bashkëpunimin në gati të gjitha fushat që janë përgjegjësi e BE-së. Asociimi zhvillohet përmes një kornize institucionale e cila jo vetëm që përfshin mekanizmat vendimmarrës por po ashtu ofron edhe dialog intensiv një nivelin e shërbimit civil.

Prandaj BE-ja mund të lidh marrëveshje të tilla me vendin e tretë nëse autoritetet e tij politike dhe gjyqësore janë të afta që të sigurojnë që marrëveshjet respektohen, përmbahen dhe zbatohen. Është pikërisht qëllim i këtij studimi të fizibilitetit që të vlerësoj nëse zhvillimi politik dhe ekonomik i Kosovës lejon marrjen e obligimeve të gjera nga marrëveshja e asociimit. Nga pikëpamja ligjore, sidoqoftë, mjafton të thuhet se fakti që disa Shtete Anëtare nuk e kanë pranuar Kosovën si shtet i pavarur nuk paraqet pengesë ligjore për autoritetet e Kosovës për të zbatuar obligimet që dalin nga marrëveshja e asociimit.

²

SWD(2012) 339 final.

Asocimi i Kosovës me Bashkimit Evropian nuk bie ndesh me faktin që disa Shtete Anëtare të BE-së kanë qëndrime të ndryshme mbi statusin e Kosovës nën të Drejtën Ndërkombëtare. Për më shumë, natyra e saktë ligjore e marrëveshjes duhet të caktohet në fund të negociatave, përkthazi me përmbajtjen aktuale dhe duke marrë parasysh kontekstin ligjor.

Prania ndërkombëtare në Kosovë nuk paraqet pengesë për autoritetet e Kosovës që të zbatojnë obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Një marrëveshje e tillë nuk do të ishte në kundërshtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 të vitit 1999 dhe është në përputhje me praninë aktuale të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) është themeluar për të mbikëqyrur zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës mbi Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Me 10 Shtator, Grupi Ndërkombëtar Drejtues (GND), pasi ka vendosur se Kosova i ka përmbushur ne thelb kushtet e Propozimit Gjithëpërfshirës dhe pasi Kosova ka miratuar kornizën e domosdoshme kushtetuese dhe ligjore, ka deklaruar përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës dhe fundin e mandatit të Përfaqësuesit Ndërkombëtar Civil. Si pasojë do të mbyllet Zyra Civile Ndërkombëtare në fund të vitit 2012. Pas këtij procesi, BE-ja do të merr rol më të theksuar në Kosovë.

Qëllim kryesor i misionit të BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, është të ndihmoj dhe përkrah autoritetet e Kosovës në fushat kyçe të sundimit të ligjit – policia, gjyqësia dhe doganat. Mandati i tij ka përgjegjësi të caktuara ekzekutive. Nëse bëhet një marrëveshje e asociimit, ky mision i BE-së, brenda kësaj kornizë, do të përkrah autoritetet e Kosovës në zbatimin e marrëveshjes së tillë.

Aspekte që kanë të bëjnë me veriun e Kosovës

Veriu i Kosovës i referohet një hapësire e cila përfshin komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit si dhe pjesës së Mitrovicës në veri të lumit Ibër. Kjo hapësirë banohet më së shumti me serbë.

Serbia ka vazhduar që të financoj dhe mbaj struktura të caktuara në këtë pjesë të Kosovës. Kjo përfshin jo vetëm spitalet dhe shkollat por edhe administratat komunale, shërbimet e sigurimit dhe strukturat gjyqësore. Aktualisht, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës mund të operoj vetëm me përkrahje të gjykatësve të EULEX-it. Kompania serbe e rrymës ende mban të palicencuar degën e vet të furnizimit me rrymë në veri, kompanitë serbe të telefonisë mobile vazhdojnë të operojnë të palicencuara dhe popullata në veri shpesh përdor rrugë alternative për të kaluar vijën kufitare.

Veriu i Kosovës përballlet me situatë të vështirë ekonomike. Popullata lokale është tepër e varur nga punësimi publik dhe asistenca e financuar nga Beogradi.

3

Mund të përmendet prania e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë që është përkrahur nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë (ZPL), i emëruar nga Këshilli i Zbatimit të Paqes për të mbikëqyrur zbatimin civil të Paqes nga Marrëveshja e Dejtonit dhe si i tillë nuk është konsideruar si pengesë ligjore për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Bosnjës dhe Hercegovinës.

Fushat me potencial natyror, sikurse është miniera e Trepçës, mbeten fare të pazhvilluara.

Në vitin 2011, është bërë regjistrimi i popullsisë në Kosovë por në të nuk janë përfshirë të dhënat e kësaj pjese të Kosovës. Gjatë zgjedhjeve të fundit në Kosovë, dalja në zgjedhje në këto komuna ka qenë skajshmërisht e ultë. Në Maj të vitit 2012, komunat e Zubin Potokut dhe Zveçanit njëanshëm kanë organizuar zgjedhje të ndara lokale në të njëjtën kohë kur janë mbajtur ato në Serbi. Këto zgjedhje nuk janë njohur nga Prishtina, Beogradi apo bashkësia ndërkombëtare.

Pas vendosjes së policisë së Kosovës dhe Doganave në pikë-kalimet kufitare gjatë verës së vitit 2011, janë ngritur disa barrkada. Shumica nga to tani janë larguar. Ende është një barrkadë përgjatë urës mbi lumin Ibër. Situata aktuale me shpërthime të dhunës dhe tensione të shpeshta nuk është situatë e qëndrueshme. KFOR dhe EULEX kanë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar në zbutjen e situatës.

Dialogu Beograd/Prishtinë

Situata në veri të Kosovës mbetet një sfidë për Kosovën, Serbinë, rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe bashkësinë ndërkombëtare. Pas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të Shtatorit të vitit 2010, BE-ja ka ndihmuar në dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Dialogu është nisur në Mars të vitit 2011 për të promovuar bashkëpunimin, arritur përparimin në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve. Deri më tani, palët kanë arritur marrëveshje në lëvizjen e lirë të njerëzve, vulat doganore, njohjen e diplomave universitare, regjistrat civil, MIK (Menaxhimin e Integruar të Kufirit) dhe bashkëpunimin rajonal. Të dyja, Kosova dhe Serbia, duhet të vazhdojnë me mirëbesim zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani dhe të angazhohen me bashkëpunim në zgjidhjen e çështjeve me ndihmën e BE-së.

Përparimi në çështjet që kanë të bëjnë me veriun kërkojnë nga të gjithë aktorët e përfshirë të punojnë së bashku në një frymë konstruktive. Autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë punën e tyre. Ato duhet të promovojnë një Kosovë multietnike dhe të respektojnë nevojat e veçanta të popullatës lokale. Kosova ka vazhduar të përgatis agjendën për veriun në përputhje me Përfundimet e Këshillit të Dhjetorit të vitit 2011. Pakicat jo-serbe në veri gjithashtu do përfitojnë nga normalizimi i kësaj pjese të Kosovës.

Situata aktuale është sfidë dhe duhet të përmirësohet urgjentisht. Në këtë drejtim, Komisioni konsideron se përfitimet nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit duhet të shërbej si nxitje e popullatës në tërë Kosovën përfshirë këtu edhe veriun.

2. MARRËDHËNIET NË MES TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE KOSOVËS

Kosova gradualisht i ka forcuar strukturat e veta që merren me procesin e integrimi evropiane. Kosova e ka të ndërtuar Këshillin Kombëtar për integrimet në BE që kryesohet nga Presidentja. Qëllimi i këtij Këshilli Kombëtar është të mobilizoj institucionet e Kosovës të angazhohen në agjendën e tyre evropiane. Ministria e Integritimit Evropian udhëheq me një Task Forcë për Integrimet Evropiane. Ministria ka demonstruar aftësi të mirë në mobilizimin e ministrive dhe institucioneve tjera duke bashkërenduar një kontribut gjithëpërfshirës të Kosovës në përgatitjen e këtij studimi të fizibilitetit.

Në vitin 2009, Komisioni ka lëshuar një Komunikatë për Kosovën e cila ka përfshirë rekomandimet për një numër hapash praktik që BE do të mund të merrte për të siguruar përparimin e vazhdueshëm të Kosovës drejt BE-së.

BE-ja ka nisur dialogun për liberalizimin e vizave dhe ka paraqitur udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave tek autoritetet e Kosovës; autoritetet e Kosovës tani kanë dorëzuar raportin e tyre të parë. BE-ja është pajtuar të zgjeroj Masat Autonome të Tregtisë për Kosovën në vitin 2011. Kosova po ashtu është përfshirë në Konventën Rajonale të Rregullave të Origjinës Pan-Euro-Med, në të cilën mund të merr pjesë aktivisht pasi që marrëveshja të nënshkruhet. Kosova po përgatitet për integrim në kornizën për mbikëqyrjen ekonomike dhe fiskale. Në Dhjetor të vitit 2011, Këshilli ka vënë re se zhvillimi socio-ekonomik i Kosovës do të zhvillohej përmes anëtarësimit në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në Mars të vitit 2011, Komisioni i ka rekomanduar Këshillit që ta autorizoj për të negociuar marrëveshjen kornizë e cila lejon Kosovën të marr pjesë në programet e BE-së. Komisioni dhe Kosova kanë përmbushur tri cikle të Procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit. Ky Dialog është dëshmuar si një mekanizëm efektiv për të monitoruar dhe këshilluar Kosovën në masat që duhet të ndërmar në zbatimin e agjendës evropiane për reforma. Ky mekanizëm po ashtu kërkon edhe këshillimin me organizatat e shoqërisë civile.

Kosova përfiton nga programi i Instrumentit të Asistencës para Anëtarësimit, bashkëpunimi ndërkufitar me Shqipërinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Pjesa e Kosovës nga skemat e Erasmus-Mundus, Tempus dhe Young Cell nën këtë Instrument është rritur. Gjithsej brenda viteve 2007 – 2013, i janë dhënë Kosovës €635.4 milion.

Së bashku me autoritetet e Kosovës, Komisioni ka nisur Dialogun Strukturor mbi Sundimin e Ligjit. Kjo demonstroi përkushtim politik të autoriteteve të Kosovës dhe të Komisionit për tu ballafaquar me sfidat në këtë fushë qysh në fazat e hershme të procesit të zgjerimit.

Prania e BE-së në Kosovë

Zyra me dy kapela e Përfaqësuesit Special të BE-së dhe Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar është ndarë. Zyra e Përfaqësuesit Special të BE-së dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian janë shkruar në një Zyrë të BE-së. Kjo ka rritur praninë dhe vizibilitetin e pranisë së BE-së në Kosovë. Për të pasqyruar aftësitë e shtuara të autoriteteve të Kosovës, është rikonfiguruar dhe zvogëluar mandati i EULEX-it. Për të ndihmuar autoritetet e Kosovës që të ballafaqohen me sfidat që kanë mbetur, mandati i tij është zgjatuar deri në Qershor të vitit 2014. Kosova ka nevojë të mbaj bashkëpunimin e mirë me misionin dhe të përkrah aktivisht zbatimin e mandatit të tij. Komisioni bashkëpunon ngushtë me EULEX-in përmes ri-konfigurimit për të siguruar një tranzicion të lehtë dhe përkrahje të qëndrueshme për autoritetet e Kosovës.

Kosova në kontekstin rajonal

Kosova merr pjesë në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, Traktatin e Bashkësisë së Energjisë, Observatori i Transportit të Evropës Jug-Lindore dhe në CEFTA, dhe është e gatshme të marr pjesë edhe në nismat tjera rajonale.

Formula për pjesëmarrjen e Kosovës në marrëveshjet e bashkëpunimit rajonal të miratuara në Shkurt të vitit 2012 është një bazë e mirë për Kosovën të rritë dhe zgjeroj pjesëmarrjen e saj të drejtpërdrejtë në këto mekanizma. Këto përfshijnë Traktatin e Komunitetit të Transportit, bashkëpunimin gjyqësor dhe aranzhimet për punësim në politika sociale brenda kornizës së Punësimit dhe Rrjetit të Politikave Sociale të BE-së dhe Rrjetit të Shëndetit të EJL. Duhet siguruar edhe pjesëmarrja e plotë e Kosovës në Dekadën e Romëve.

3. VLERËSIMI

3.1. Çështjet politike

Sistemi politik i Kosovës është i bazuar në parimet e demokracisë parlamentare. Këto parime janë të shkruara në kushtetutën dhe kornizën ligjore të Kosovës. Gjatë tri viteve të shkuara, **funksionimi i institucioneve demokratike dhe respektimi i sundimit të ligjit** është konsoliduar. Janë themeluar institucionet e domosdoshme.

Presidenti, qeveria dhe parlamenti janë institucionet kryesore përgjegjëse për shtyrjen përpara të këtyre proceseve të reformës. Gjykata Kushtetuese ka luajtur një rol të rëndësishëm në garantimin e parimeve demokratike dhe respektimin e kushtetutës, për shembull përmes vendimit të saj mbi mandatin e Presidentes Aktuale. Bashkëpunimi për legjislacionin në mes të qeverisë dhe parlamentit po ashtu është duke u përmirësuar gradualisht. Kosova ka dëshmuar përkushtim të mjaftueshëm për parimet e demokracisë në qeverisje për të nisur kështu negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Për të përmbushur obligimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje Kosova duhet të vazhdojë në zbatimin e reformës demokratike. Në veçanti Kuvendi duhet të fuqizoj mbikëqyrjen e tij mbi ekzekutivin dhe sektorin e sigurisë përmes rishikimit të legjislacionit dhe monitorimit të zbatimit të politikave dhe ligjeve. Duhet të rritet pavarësia financiare dhe administrative e Kuvendit nga qeveria. Kjo mund të arrihet përmes miratimit të legjislacionit mbi statusin e shërbyesit civil në Kuvend. Është po ashtu me rëndësi të sigurohet që plani i buxhetit për Kuvendin të ndryshohet nga qeveria në konsultim me Kuvendin para sa qeveria ta dërgon propozimin në Kuvend për miratim.

Kosova ka mbajtur zgjedhjet e rregullta në të dyja nivelet, qendror dhe lokal. Sistemi zgjedhor lejon garën në mes të partive të ndryshme politike dhe zgjedhjen e lirë të votuesve. Kjo ka rezultuar në përbërje të ndryshme të koalicioneve qeverisëse. Zgjedhjet e fundit të përgjithshme të mbajtura më 2010/2011 kanë demonstruar që partitë e reja mund të hyjnë në Kuvend. Kosova është e gatshme të fillojë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Në të njëjtën kohë, këto zgjedhje janë karakterizuar më mangësi serioze dhe vështirësi teknike. Prandaj Kosova duhet të sigurohet që korniza ligjore përmirësohet ashtu që të pasqyrojë praktikën dhe standardet më të mira të BE-së që dalin nga një marrëveshje e tillë.

Përkritazi me sundimin e ligjit, korniza ligjore është komplekse, duke përfshirë legjislacion nga ish-Jugosllavia dhe nga Republika Federale e Jugosllavisë, legjislacioni i UNMIK-ut dhe legjislacioni i ri i Kosovës. Disa elemente të reformës së domosdoshme ligjore për luftimin e krimit të organizuar janë vendosur tashmë. Disa ligje të rëndësishme ende mungojnë apo duhet të ndryshohen, sidomos në fushën e pastrimit të parave dhe konfiskimit të pasurisë. Në afat të shkurtë Kosova duhet të demonstrojë përkushtim të qartë në dhënien e e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë nisjen e hetimeve në bashkërendim të ngushtë me EULEX-in. Kosova duhet të miratojë legjislacion të ri mbi konfiskimin e pasurisë dhe të përshtat me *acquis* ligjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Zbatimi i kornizës ligjore për luftimin e formave të ndryshme të krimit të organizuar mbetet një sfidë e rëndësishme. Që Kosova të përmbush obligimet e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, duhet të jepen dëshmi konkrete të rezultateve të luftimit të krimit të organizuar dhe kjo duhet të jetë prioritet. Kosova po ashtu duhet të vazhdoj fuqizimin dhe zbatimin e legjislacionit sidomos në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, drogë, prekursorët e drogës dhe trafikimin me armë. Kosova duhet po ashtu të përmirësoj besueshmërinë e statistikave të saja.

Kosova ka ndërtuar elemente të rëndësishme të kornizës legjislative që janë të domosdoshme për luftimin e korrupsionit. Shembujt mund të përfshijnë deklarinë e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, treguesit e fshehtë të shkeljeve, prokurimit publik dhe financimit të partive politike. Është me rëndësi që Kosova të arrij rezultate të prekshme në këtë fushë.

Gjatë tri viteve të fundit, shërbimi prokurorial dhe policia janë riorganizuar ashtu që të fuqizojnë kapacitetet e tyre në ballafaqimin me korrupsionit. Kosova ka një Agjenci Kundër Korrupsionit me të drejta të hetimit administrativ dhe të raportimit. Kapacitetet e Agjencisë përputhen me përgjegjësitë e saj. Në afat të shkurtë, Kosova duhet të demonstroj një përkushtim të qartë për të ofruar rezultate në luftimin e korrupsionit, përfshirë nisjen e hetimeve, në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in. Kosova duhet të miratoj një strategji të re kundër korrupsionit.

Për të përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Kosova duhet të zbatoj në mënyrë aktive legjislacionin e saj kundër korrupsionit dhe të themeloj një mekanizëm efektiv për parandalimin e korrupsionit. Kosova duhet të vejë si prioritet ofrimin e dëshmive konkrete si rezultat i luftës kundër korrupsionit. Këto mund të jenë hetime të suksesshme dhe përndjekje ligjore e zyrtarëve të zgjedhur që janë shpallur fajtor për korrupsion. Kosova duhet po ashtu të përmirësoj besueshmërinë e statistikave në këtë fushë.

Përfundimet e Këshillit të Prillit 1997 nënvizojnë rëndësinë e procedurave të riatdhesimit. Brenda kornizës së procesit të liberalizimit të vizave, Kosova ka miratuar një ligj mbi riatdhesimin dhe vazhdon të bashkëpunoj në çështjet e riatdhesimit me Shtetet Anëtare të BE-së. Duhet që ky ligj të zbatohet plotësisht dhe të sigurohet re-integrimi i personave të riatdhesuar.

Gjatë tri viteve të fundit, Kosova ka miratuar legjislacionin mbi reformat kryesore gjyqësore. Parimet e paanshmërisë, pavarësisë, llogaridhënies dhe efikasitet janë në zemrën e kësaj reforme. Reformat ndryshojnë strukturën e sistemit gjyqësor dhe prokuroria. Është themeluar Këshilli Prokurorial derisa është fuqizuar Këshilli Gjyqësor. Institucionet kryesore të gjyqësorit tanimë ekzistojnë megjithëqë në gjykatat në Mitrovicën veriore janë të pranishëm vetëm gjykatësit e EULEX-it. Ata kanë rritur kapacitetet e tyre dhe kanë një perceptim të mirë se ti shtojnë përpara këto reforma. Përpjekjet për zvogëlimin e numrit të rasteve që kanë mbetur pa u shqyrtuar po japin ngadalë rezultatet e tyre. Derisa është në zbatim të strukturës së re të gjykatave, Kosova duhet të siguroj që Prokuroria Speciale, që është përgjegjëse për rastet e krimit të organizuar, krimet e luftës dhe korrupsionit, të mbaj kompetencat e saja.

Është e qartë që Kosova has në shumë sfida të rëndësishme në këtë fushë. Për të përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit Kosova duhet të përmirësoj efektivitetin, llogaridhënien dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Duhet të zbatoj me sukses katër reformat kryesore të ligjeve duke siguruar konsistencën mes tyre. Kosova duhet të marrë masa të zvogëloj numrin e rasteve të pashqyrtuara. Autoritetet e Kosovës duhet të ofrojnë siguri dhe mbrojtje adekuate për gjykatësit, prokurorët, paditësit si dhe stafit të gjykatës.

Kosova duhet të siguroj që proceset gjyqësore kryhen në hapësira përkatëse dhe këto procese të jenë në përputhje me procedurat gjyqësore. Punësimi i gjykatëseve dhe prokurorëve nga pakicat, siç kërkohet me ligj, duhet të vazhdoj tutje.

Korniza ligjore e cila paraqet kushtet themelore për një shërbim civil profesional dhe stabil në masë të madhe tanimë ekziston. Legjislacioni është i frymëzuar nga qasjet më të fundit të **administratës publike** në Evropë. Kapacitetet e administratës publike në nivelin qendror janë më të mira se ato në nivelin komunal. Kosova ka themeluar institucionin e Ombudspersonit i cili është organi kryesor në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore. Sidoqoftë, Avokati i popullit has në vështirësi, më së shumti në buxhet dhe zyra.

Në afat të shkurtë Kosova duhet të miratoj legjislacionin e domosdoshëm sekondar mbi shërbimin civil dhe mbi pagat e shërbimit civil. Për më shumë, duhet të ndaj zyra për Ombudspersonin dhe të siguroj pavarësinë buxhetore të tij. Qeveria duhet të përfshij propozimet buxhetore të Ombudspersonit pa ndryshim në draft buxhetin e përgjithshëm që i dërgohet kuvendit për miratim.

Në të njëjtën kohë, Kosova duhet të vazhdoj të zbatoj reformat e domosdoshme të administratës publike. Për të përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Kosova duhet të shënoj përparim në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit të administratës publike dhe legjislacionit përkatës. Duhet po ashtu të siguroj reformën e administratës publike përfshirë financimin dhe numrin e punëtorëve. Përqindja e personave që i përkasin pakicave në administratë publike duhet të rritet. Një administratë publike efikase është kyçe për zbatimin e suksesshëm të një marrëveshje.

Kushtetuta e Kosovës dhe korniza e përgjithshme legjislative ofron garanci për të **drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave**. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e KB-ve apo e Këshillit të Evropës, kushtetuta e saj përcakton se konventat e KB-së dhe Këshillit të Evropës dhe protokollat e saja janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë dhe kanë përparësi ndaj legjislacionit të Kosovës. Gjatë tri viteve të fundit Kosova ka shënuar hapa në zbatimin e këtyre dispozitave në praktikë.

Janë disa sfida që duhet të trajtohen nga Kosova për të për të përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Kjo fushë është sidomos e rëndësishme në dritën e Strategjisë së re dhe Planit të Veprimit të BE-së mbi të Drejtat e Njeriut dhe Demokracisë të miratuar nga Këshilli në Qershor të vitit 2012. Kosova duhet të hetoj dhe përndjek penalisht çfarëdo sulmi kundër gazetarëve dhe duhet të kompletoj procedurën parlamentare në ndryshimin e Kodit Penal mbi përgjegjësinë penale të mediave dhe në mbrojtjen e burimeve të lajmit. Kosova duhet po ashtu të drejtoj dhe thjeshtësoj numrin e madh të organeve të ndryshme që merren me mbrojtjen e të drejtave themelore që të sigurohet kështu monitorimi dhe fuqizimi i kornizës ligjore në këtë fushë. Kosova duhet të shënoj përparim në zbatimin e të drejtave pronësore, për shembull në uljen e rasteve gjyqësore dhe përmirësimi i vendimeve gjyqësore dhe administrative. Legjislacioni mbi mbrojtjen e të dhënave personale duhet të harmonizohet tutje me standardet e BE-së si dhe duhet të ngritën kapacitetet administrative në këtë fushë.

Korniza legjislative për mbrojtjen e pakicave ekziston tashmë përfshirë garancitë kushtetuese. Sipas kushtetutës së Kosovës, Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë. Personat që i përkasin pakicave janë të përfaqësuar mirë në Kuvend dhe në funksionet politike në nivelin qeveritar.

Me përkrahje të fortë ndërkombëtare, Kosova ka vazhduar me ofrimin e mundësisë për kthim për personat e zhvendosur. Gjithsej, mbi 23,000 persona që i përkasin pakicave janë kthyer në Kosovë që nga viti 2000.

Kosova ka filluar me zbatimin e decentralizimit përfshirë themelimin e komunave të reja ku shumica e banorëve aty janë pakicat. Në afat të shkurtë, Kosova duhet të siguroj një organ që siguron konsultim të drejtpërdrejtë mbi promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore me bashkësitë fetare, sidomos me Kishën Ortodokse Serbe.

Për të përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Kosova duhet të promovoj një Kosovë multietnike, duke krijuar kushte për serbet lokal që të ndihen si pjesë e së ardhmes së Kosovës dhe të ndihmoj në kthimin e personave që dëshirojnë të kthehen. Komisioni po ashtu pret që Kosova të vazhdon në zbatimin e decentralizimit sidomos në komunat e reja dhe të ndihmoj kështu në integrimin e serbëve të Kosovës. Buxheti, stafi dhe hapësirat duhet të jenë në dispozicion për Zyrën e Komisionarit të Gjuhës.

Kosova duhet po ashtu të zbatoj legjislacionin mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe Kishës Ortodokse Serbe, sidomos ligjet që kanë të bëjnë me qendrën historike të Prizrenit dhe fshatit Hoçë e Madhe. Transmetuesi publik i Kosovës duhet të siguroj program në gjuhën serbe. Sulmet me motiv etnik apo fetar duhet të hetohen dhe shkelësit duhet të sillen para drejtësisë dhe të adresohet diskriminimi. Sa i përket Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve të cilët ende jetojnë në kushte shumë të varfra, Kosova duhet të demonstroj përparim në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit përfshirë ndarjen e burimeve të domosdoshme.

Mbi krimet e luftës, Kosova ka mbajtur bashkëpunim të mirë me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Kosova po ashtu duhet të përkrah punën e Task Forcës Speciale Hetuese të EULEX-it.

3.2. Çështjet ekonomike

Kosova duhet të zbatoj reformat fillestare të domosdoshme për themelimin e ekonomisë së plotë të tregut. Kjo është e mjaftueshme për të vendosur marrëdhënie kontraktuale me Ballkanin Perëndimor sikurse është e deklaruar në Përfundimet e Këshillit në Prill të vitit 1997. Në të njëjtën kohë, ekonomia e Kosovës ballafaqohet me shumë sfida të rëndësishme. Papunësia është shumë e lartë dhe sektori privat mbetet i dobët. Ekonomia jo-formale është e përhapur derisa duhet forcuar zbatimi i ligjit për të përmirësuar ambientin e biznesit dhe të përkrah zhvillimin e sektorit privat. Përpjekje të rëndësishme duhen bërë për të ndihmuar politikën ekonomike, për tu ballafaquar me konsolidimin fiskal, krijimin e vendeve të punës dhe çështjet e konkurrencës dhe promovimin e investimeve për të arritur një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

3.3. Mundësia për të marrë përsipër obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

Analiza nga Komisioni pohon se për shumicën e sektorëve, Kosova ka vënë tashmë kornizën ligjore dhe ka kapacitetet elementare administrative. Kjo është e mjaftueshme për të filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Në të njëjtën kohë, Dokumenti i Punës thekson se ekzistojnë boshllëqe të mëdha dhe se shumë çështje duhet të adresohen nga Kosova për të përmbushur obligimet që dalin nga një marrëveshje e tillë.

Tregtia është një sektor kryesor në kontekst të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Kosova ka një regjim liberal tregtar dhe është një ekonomi shumë e hapur me shumë pak kufizime në tregti. Kosova është anëtare e CEFTA-a. Kosova po ashtu ka një qasje pa dogana në tregun e BE-së për prodhimet e përpunuara dhe gati të gjitha prodhimet bujqësore, përmes regjimit autonom të BE-së. Kosova ka ndërmarrë hapa në modernizimin e kornizës rregullatore për lëvizjen e lirë të mallrave përkitazi me përafrimin me *acquis* duke miratuar legjislacionin e ri sipas standardeve të BE-së dhe duke përafruar ato që nuk përputhen me ato të BE-së.

Ministria për Tregti dhe Industri është duke u ri-organizuar për të përmirësuar kapacitetet në këtë fushë përkitazi me pjesët që kanë të bëjnë me tregtinë brenda Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ristrukturimi ende nuk është përfunduar. Prandaj, në afat të shkurtër, Kosova duhet të zbatoj vendimet qeveritare për ristrukturimin e Ministrisë dhe të themeloj një strukturë e cila do të udhëheq dhe bashkërendoj negociatat e tilla. Për të përmirësuar kuptimin e ndikimit të dispozitave të tregtisë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mbi Ekonominë e Kosovës, Kosova duhet të përgatis një studim analitik duke përfshirë deklaratatë të qarta për prioritetet e saja të negocimit.

Janë disa fusha tjera ku Kosova duhet të shënoj përparim për të përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Një nga elementet kyçe është zbatimi i kornizës ligjore mbi tregtinë, konkurrencën dhe çështjet e tregut të brendshëm. Tregtia e paligjshme me kafshë dhe therja e tyre mbetet ende çështje dhe Kosova duhet të ngrit kontrollin mbi këto praktika. Kontrolli në tregjet e kafshëve po ashtu duhet të fuqizohet. Kosova do të përfitonte nga statistikat e përmirësuara mbi biznesin.

Për të përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Kosova duhet të ngrit kapacitetet e saja për fito-sanitarinë dhe kontrollin veterinar të importit si dhe kapacitetet e transferimit të mostrave. Siguria e transferimit të ushqimit dhe inspektorët veterinar nga komunat e Kosovës dhe Agjencia Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës duhet të finalizohen. Regjistrimi i të dhënave në identifikimin e kafshëve, baza e të dhënave të regjistrimit dhe të lëvizjes duhet të sistematizohen. Laboratorët e përfshira në kontrollin e ushqimit duhet të akreditohen.

4. PËRFUNDIMET E PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIMET

Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në rrugën e saj drejt BE-së që nga fundi i konfliktit në fund të viteve të 90-ta. Ka vendosur një kornizë stabile institucionale dhe ligjore të nevojshme për qeverisje demokratike dhe mbrojtje të drejtave të njeriut për të gjitha pakicat që jetojnë në Kosovë si dhe të drejtat për kthim të personave të zhvendosur.

Korniza e domosdoshme institucionale dhe ligjore që siguron sundimin e ligjit tanimë ekziston. Legjislacioni siguron garanci të fuqishme të pavarësisë së gjyqësorit. Institucionet themelore të gjyqësorit kanë filluar të ushtrtojnë detyrat e tyre. Korniza ligjore që është e domosdoshme për administratë publike profesionale është gati e tëra në fuqi.

Kosova i ka zbatuar reformat e para në themelimin e ekonomisë së tregut. Kosova ka një regjim liberal të tregtisë dhe është në përgjithësi një ekonomi shumë e hapur me disa kufizime në tregti. Një nga sfidat kryesore ekonomike me të cilën ballafaqohet Kosova është niveli shumë i lartë i papunësisë.

Përmes angazhimit në dialogun me Serbinë të ndihmuar me BE-në, Kosova ka demonstruar një përkushtim në bashkëpunimin dhe stabilitetin rajonal. Po ashtu Kosova ka ndërtuar marrëdhënie të mira me shumicën e fqinjëve të saj. Ajo merr pjesë në disa ngjarje rajonale dhe ka kryesuar CEFTA-n.

Gjatë tri viteve të fundit Kosova ka ngritur kapacitetin e saj në arritjen e obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Aktualisht, Kosova është i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që ende nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në apo që përfiton nga liberalizimi i vizave. Në tregti, ajo mbështetet në masat autonome të tregtisë me BE-në.

Nga pikëpamja ligjore, BE-ja mund të lidh Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Kosovën sipas Nenit 217 dhe 218 TFBE. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së mund të lidhet në atë mënyrë që të respektoj pozitën e Shteteve Anëtare ndaj statusit të Kosovës. Në disa rrethana, Këshilli ka konfirmuar perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Së fundit Këshilli ka konfirmuar këtë perspektivë për Kosovën në Dhjetor të vitit 2011. Ambiciet evropiane të Kosovës kanë një përkrahje të fuqishme nga publiku i gjerë në Kosovë.

Situata në veri të Kosovës mbetet një sfidë e rëndësishme për Kosovën, rajonin e Ballkanit Perëndimor si dhe për vetë BE-në. Të gjithë aktorët e përfshirë duhet të marrin hapa proaktiv për të ndihmuar në zgjidhjen e kësaj situatë. Ata duhet të krijojnë kushtet për serbet e Kosovës që të ndihen se kanë të ardhme në Kosovë. Situata aktuale nuk është një pengesë për negociatat për marrëveshjen, por duhet përmirësime tjera që Kosova të përmbush obligimet nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Është në interes të njerëzve që jetojnë në këtë pjesë të Kosovës të përfitojnë nga dispozitat e një Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të mundshme. BE-ja është e përkushtuar që të ndihmoj të gjitha palët që mundohen të gjejnë zgjidhje në përmirësimin e jetës së njerëzve që jetojnë në veri të Kosovës.

Analiza e paraqitur në Dokumentin e Punës dhe e përmbledhur në Komunikatë sugjeron që Kosova është shumë e përgatitur të filloj negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Është qenësore që Kosova të vazhdoj zbatimin me mirëbesim të marrëveshjeve të arritura mes Beogradit dhe Prishtinës deri më tani dhe të angazhohet në këto çështje me ndihmën e BE-së. Në këtë drejtim Komisioni do të propozoj direktivat për negociatat për një marrëveshje të tillë pasi që Kosova ti ketë marrë këta hapa:

- *Sundimi i ligjit:* demonstroj përkushtim të plotë në arritjen e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë nisjen e hetimeve dhe vazhdimin e bashkëpunimit të mirë me EULEX-in. Përkrahja e punës së Task Forcës Speciale të Hetimeve. Derisa vazhdon zbatimin e strukturës së re të gjykatave, duhet siguruar që Prokuroria Speciale që është përgjegjëse për rastet e krimit të organizuar, krimet e luftës dhe korrupsionit, të mbaj kompetencat e veta. Miratimi i legjislacionit për konfiskimin e pasurisë dhe përmirësimin e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Miratimin e një strategjie të re anti-korrupsion.
- *Administrata publike:* miratoj legjislacionin të domosdoshëm sekondar mbi shërbimit civil dhe pagat e shërbimit civil. Ndarja e zyrave për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe sigurimi i pavarësisë së tij buxhetore përmes obligimit të qeverisë që të përfshij propozim-buxhetin e Ombudspersonit pa e ndryshuar atë në propozimin e përgjithshëm për buxhet kur i dorëzohet Kuvendit për shqyrtim.

- *Mbrojtja e pakicave:* sigurimi i ekzistencës së një organi që mundëson konsultimin e drejtpërdrejt mbi promovimin e mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore, kryesisht me Kishën Ortodokse Serbe.
- *Tregtia:* zbatimi i vendimit të qeverisë mbi ristrukturimin e Ministrisë për Tregti dhe Industri, vendosja e mekanizmit që do të udhëhiqte dhe bashkërendonte me negociatat brenda Kosovës dhe të përgatis analizën e ndikimit të aspekteve tregtare të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Kosova duhet të vazhdoj të demonstroj përkushtimin ndaj agjendës së BE-së për reforma të përgjithshme përfshirë shtimin e përafrimit të legjislacionit me *acquis*. Që të përmbush obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Kosova duhet të shënoj përparim në këto fusha:

- *Sundimin e ligjit:* ofroj dëshmi konkrete të rezultateve që janë arritur në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit si një prioritet dhe fuqizoj legjislacionin dhe zbatimin e tij sidomos në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, droga dhe prekursorët e saj si dhe trafikimin me armë. Përmirësimin e besueshmërisë së statistikave në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përkrah aktivisht zbatimin e mandatit të EULEX-it, përfshirë Task Forcën Speciale për Hetime. Siguroj riatdhesimin nga Shtetet Anëtare.
- *Gjyqësori:* merr hapat e duhur për të zvogëluar numrin e rasteve të pashqyrtuara në gjykatë. Zbatoj reformën gjyqësore duke siguruar konsistencën ndërmjet ligjeve mbi Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial dhe prokurorinë. Ofroj siguri dhe mbrojtje të duhur për gjykatësit dhe stafin e gjykatave si dhe për prokurorët, dëshmitarët dhe ata që tregojnë për shkeljet dhe ofroj mbrojtje efektive kundrejt kërcënimeve dhe frikësimeve. Siguroj procese gjyqësore në përputhje me procedurat gjyqësore. Të vazhdoj me punësimin e gjykatësve dhe prokurorëve nga pakicat ashtu siç është e përcaktuar në kornizën legjislative.
- *Administrata publike:* të shënoj përparim në strategjinë dhe planin e veprimit për administratën publike dhe legjislacionin përkatës. Siguroj reformën e qëndrueshme të administratës publike përfshirë financimin dhe personelin. Rris përqindjen e përgjithshme në administratën publike të personave që vijnë nga pakicat.
- *Reforma zgjedhore dhe kuvendi:* siguroj që korniza ligjore mbi zgjedhjet paraqet në mënyrë më të duhur praktikat më të mira në BE-së dhe që zbatimi është po ashtu në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kuvendi duhet të rris mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit përmes shqyrtimit të legjislacionit dhe monitorimit të zbatimit të politikave dhe ligjeve. Financimi dhe administrata e Kuvendit duhet të jetë më e pavarur nga qeveria kryesisht përmes miratimit të legjislacionit mbi shërbyesit civil të Kuvendit duke siguruar që propozim-buxheti i Kuvendit ndryshohet nga qeveria në konsultim me Kuvendin para se ai të dërgohet te Kuvendi për miratim.
- *Të drejtat e njeriut dhe ato themelore:* hetimi dhe përndjekja e çfarëdo sulmi mbi gazetarët dhe procedurat e plota parlamentare për ndryshimin e Kodit Penal për përgjegjësinë penale të mediave dhe mbrojtjen e burimeve të lajmit. Drejtoj dhe thjeshtësoj numrin e madh të organeve që merren me mbrojtjen e këtyre të drejtave duke siguruar monitorim efektiv dhe zbatim të kornizës ligjor në këtë fushë.

Shënoj përparim në zbatimin e të drejtave pronësore përmes zvogëlimit të rasteve të pakryera dhe përmirësimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe administrative. Harmonizimi i legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve të BE-së dhe përqendrimi në zbatimin sidomos në përgatitjen e legjislacionit sekondar në ndërtimin e kapaciteteve administrative.

- *Mbrojtja e pakicave:* promovimi i Kosovës multietnike; krijimi i kushteve për serbet e Kosovës që të ndjehen si pjesë e së ardhmes së Kosovës dhe krijimin e kushteve për kthim për personat që dëshirojnë të kthehen. Vazhdoj zbatimin e decentralizimit sidomos në komunat e reja. Ndarja e buxhetit, stafit dhe personelit për Zyrën e Komisionarit Gjuhësor. Zbatoj legjislacionin që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe Kishës Ortodokse Serbe. Siguroj transmetimin në gjuhën serbe në transmetuesin publik. Hetoj dhe përndjek secilin sulm me motive etnike apo fetare dhe të sjell dorasit para drejtësisë. Përmirësim në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët përfshirë ndarjen e buxhetit të domosdoshëm.
- *Tregtia dhe çështjet e tregut të brendshëm:* zbatoj kornizën ligjore mbi tregtinë, konkurrencën dhe tregun e brendshëm. Ris kontrollin mbi tregtinë e paligjshme me kafshë dhe therjen e tyre dhe përmirësimi i tregjeve të kafshëve. Përmirësoj statistikën e biznesit.
- *Fito-sanitaria dhe çështjet veterinerë:* përmirësoj objektet e fito-sanitarisë dhe kontrollin veterinar mbi importin si dhe kapacitetet e transferim të mostrave. Fuqizoj kontrollin e sigurisë së ushqimit dhe fito-sanitarisë përfshirë finalizimin e transferim të sigurisë së ushqimit nga komunat tek Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës. Sistematizoj regjistrimin e të dhënave në identifikimin e kafshëve, si dhe bazën e të dhënave të lëvizjes së kafshëve. Akreditoj laboratorët e përfshirë në kontrollin e ushqimit.

Komisioni fton Kosovën të intensifikoj reformat në këto fusha me fokus në zbatimin e tyre. Shpejtësia e progresit varet nga Kosova. Konsensusi publik dhe politik në Kosovë mbi agjendën e BE-së për reformë janë kyçe në zbatimin e shpejtë të saj. Komisioni do të monitoroj progresin që shënon Kosova përmes Procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit, Dialogun e Strukturuar mbi Sundimin e Ligjit, procesin e dialogut për viza si dhe raportet e rregullta të progresit.